



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM
Nr. 457, datë 24.07.2023

PËR
PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME
PËLQIM PËR GJYQTAREN ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 97, datë 06.03.2023, “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarës znj. {...}”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtarja e transferuar me pëlqim, të jetë transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtaren znj. {...}.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR